



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF - Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, sipas kërkesës së Drejtorit të DKA-sa të datës 28.06.2018, Kryetari i Komunës merr

## VENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

### Neni 1 Përbërja e Komisionit

Formohet komisioni për përcaktimin e çmimit minimal për shitjen e prodhimeve bimore të grurit në përbërje si vijon:

1. Ismajl Mustafa, Drejtorati për Arsim, Kryesues
2. Ismet Haziri, Drejtorati për Arsim, anëtar
3. Pajtim Krasniqi, Drejtorati për Inspeksion, anëtar

### Neni 2 Detyrat e Komisionit

Detyrë e Komisionit është që të përcaktojë çmimin fillestar për shitjen e grurit në sipërfaqe prej 4 ha, që janë në pronësi të SHMP "Adem Gllavica në Lipjan- Ekonomia bujqësore, që në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse pas përcaktimit të çmimit fillestar do të shitet nëpërmjet ankandit publik.

### Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë ndërsa me kopjen e këtij Vendimi do të njoftohen, Drejtorati për Arsim, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit .

1Nr. 400-39575  
Lipjan, më 02.07.2018

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti

